

FLETËPALOSJE ME INFORMACIONE PËR PUNONJËS: PUNËSIME TË PËRKOZHSHME NË SEKTORIN E NDËRTIMIT

Fondacioni për daljen fleksibël në pension në sektorin e ndërtimit (FAR), paguan pensione të parakohshme nga mosha 60 vjeç deri sa të arrihet mosha e duhur për pensionin AHV nëse përbushen kushtet e nevojshme. Sipas Art. 14 GAV FAR (Kontrata kolektive e punës për daljen fleksibël në pension në sektorin e ndërtimit) kjo ndodh nëse për 15 vite (ose të paktën 10 vite për një pension të reduktuar) brenda 20 viteve të fundit dhe për 7 vitet e fundit prej këtyre para tërheqjes së përfitimeve, punësimi i cili i nënshtrohet detyrimit të kontributeve shoqërore është zhvilluar pa ndërprerje në një kompani brenda juridiksionit të GAV FAR dhe janë marrë kontributet. Lejohet një ndërprerje gjatë 7 viteve të fundit para fillimit të pensionit për shkak të një periudhe maksimale papunësie prej 2 vitesh. Regjistrimi i menjëhershëm tek RAV (Qendra e punësimit të papunëve) është gjithsesi i detyrueshëm.

Si periudha pune quhen dhe periudhat gjatë të cilave punonjësit janë caktuar në punë nga një agjenci e cila ofron shërbime për furnizimin me staf (agjenci e cila jep me qira një staf ose agjenci ndërmjetësimi) tek kompania e cila i nënshtrohet GAV FAR, me kushtin që funksioni në kompaninë ku është zhvilluar veprimtaria të jetë nën juridiksionin e GAV FAR dhe kontributet të jenë marrë në këtë periudhë në përputhje me Art.8 GAV FAR. Nga ana tjetër, nuk zë vend këtu vartësia nga GAV prej agjencisë e cila ofron shërbime për furnizimin me staf ose e një grupi pune (Arbeitsgemeinschaft) të përfshirë në procesin e punësimit.

Informacione mbi këtë çështje gjenden në faqen www.far-suisse.ch/leistungen

Për të verifikuar nëse ju takon pensioni në fjalë, fondacionit FAR i duhet një dokumentacion i pandërprerë i marrëdhënies suaj të punës nga mosha 40 deri në atë 60 vjeçare.

Punësimi nëpërmjet agjencive të cilat ofrojnë shërbime për furnizimin me staf (agjenci e cila jep me qira një staf ose agjenci ndërmjetësimi) shpesh harrohet për shkak të kohës së shkurtër të punësimit, **prandaj fondacioni FAR ju rekomandon urgjentisht të ruani me kujdes dokumentet përkatëse, veçanërisht ato të 20 viteve të fundit para fillimit të pensionit.**

Dokumentacioni në fjalë përfshin:

- të gjitha kontratat e punës (Einsatzvertrag)
- të gjitha listat e pagave (Lohnabrechnung)
- të gjitha vërtetimet e pagave (Lohnausweis)

Këto dokumente sigurojnë që kërkesa juaj është e bazuar në fakte dhe se aplikimet për pension mund të përpunohen shpejt.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin e mirë.

Deklaratë në lidhje me mosmbajtjen e përgjegjesisë

Baza e vetme ligjore e vlefshme në lidhje me kërkesat është ajo e rregulloret të FAR, të cilat janë publikuar tek faqja <https://www.far-suisse.ch/rechtsgrundlagen/>. Asnjë kërkesë e cila vjen si rrjedhojë e kësaj flete informacioni nuk shkon përtej asaj që është e mundur bazuar tek rregulloret e FAR.

Mars 2021

Fondacioni FAR Geschäftsstelle Obstgartenstrasse 19 8006 Zvicër Telefon 043 222 58 30 www.far-suisse.ch